

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "INTEGRA RODONI"

Në Durrës, sot në datën 04/ Shkurt/ 2021, ne :

- 1) **Z. Bujar Maxhuni**, atësia Shefki, amësia Remzie, shtetas kosovar, lindur në Mitrovicë dhe banues në Kosovë, në adresën: rruga "Besim Nuka", 33, 40000, Mitrovicë, i datelindjes 14/06/1972, gjendja civile, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Pasaportën nr. PD0300987, lëshuar në datën 07/08/2017, nr. personal 1004420892, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr. repertor 1174, nr. koleksion 636, hartuar në datën 22/09/2020 nga noterja e DH.N Durrës V. Petani, nga përfaqësuesi z. Albinot Bimbashi.
- 2) **Z. Albinot Bimbashi**, atësia Hamz, shtetas Kosovar, lindur në Skenderaj dhe banues në Kosovë, Prishtinë, në adresën: rruga "Borshi", Nr. 16, 10000, lindur më 11/09/1976, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. ID1434638 dhe nr. personal 1019542714.
- 3) **Znj. Fitore Zeneli Bimbashi**, atësia Sheqir, shtetase Kosovare, lindur në Prishtinë dhe banuese në Kosovë, Prishtinë, në adresën: rruga "Borshi", Nr. 16, 10000, lindur më 11/09/1976, gjendja civile e martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. ID0660104 dhe nr. personal 1004346056.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" etj.

Z. Albinot Bimbashi, znj. Fitore Zeneli Bimbashi dhe z. Bujar Maxhuni themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "**Integra Rodoni**"sh.p.k.

Selia e shoqërisë është në Durrës, në adresën: Shetaj, nr pasurie 59/70, volum 6, faqe 202, ndërtesë 1 kat.

Objekti i shoqërisë është: **konsulenca për integritime europiane dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **pa afat.**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1'000 (Një mijë) lekë, i përbërë nga 3 kuota,

- 1) Nje kuotë me vlerë nominale 500 Lekë, me 50 % pjesëmarrje zotërohet nga ortaku themelues z. Bujar Maxhuni.
- 2) Nje kuotë me vlerë nominale 300 Lekë me 30 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar dhe zotërohet nga ortaku themelues znj. Fitore Zeneli Bimbashi
- 3) Nje kuotë me vlerë nominale 200 Lekë me 20 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar dhe zotërohet nga ortaku themelues z. Albinot Bimbashi

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.



Administrimi i shoqërisë

Administrator i shoqërisë emërohet z. Bujar Maxhuni, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

Afati i emërimit të administratorëve është pesë vjet. Administratorët emërohen sot në datën 04/Shkurt/ 2021 dhe përfundon në datën 04/Shkurt/ 2026. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombetare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare")

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryejnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i Përgjithshëm i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortakët themelues dhe nënshkruhet prej tyre në çdo faqe.

ORTAKËT THEMELUESË

Albinot Bimbashi
(Albinot Bimbashi)

Albinot Bimbashi
(Bujar Maxhuni)

Fitore Zeneli Bimbashi
(Fitore Zeneli Bimbashi)